



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Prishtinë: 16.11.2022
Kodi i ZRRE-së: V_1614_2022

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Dëshmitë e paraqitura nga palët; dhe
- Rekomandimin e DMK-së të ZRRE-së: ZRRE/DMK_R_2371_10_22.

në seancën e mbajtur më datë 16.11.2022 nxori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHET Pjesërisht ankesa e konsumatorit *Përparim Hoxha ("Progres"SH.P.K)* nga Komuna e Prizrenit si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi
- II. KESCO duhet të anulohet korrigjimin plotësues nr. 53063DPZ-9024082 datë 30.10.2020 në vlerë 30,839.26€
- III. KESCO duhet të ngarkoj konsumatorin me korrigjim plotësues në vlerë 22,814.92€ per periudhën 01/2020 deri në periudhën 09/2020 si dhe ti ofroj kontrate pagese 9 mujore

A r s y e t i m

Konsumatori *Përparim Hoxha ("Progres"SH.P.K)* në ankesën e tij drejtuar DMK-së në ZRRE me datë 06.12.2020 ka apeluar përgjigjen e KESCO-s – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 08.12.2020 lidhur me kontestimin e korrigjimit plotësues nr. 53063DPZ-9024082 datë 30.10.2020, për shkak të matjes jo të saktë të njehsorit elektrik nr. 97830357.

Me datë 09.10.2020 punëtorët e autorizuar të KEDS-it për inspektimin e pikave matëse kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit ku kanë evidentuar shpenzimet e regjistruara në njehsorin elektrik nr. 97830357 me gjendje të njehsorit elektrik aktiv TL=1565 kWh dhe TU=388 kWh dhe gjendja e njehsorit reaktiv TL=946 kVAr dhe TU=279 kVAr. Ekipi i KEDS-it ka evidentuar në procesverbal se: Gjatë kontrollimit të Grupit matës është vërejtur se një transformatorë Rrymor (në fazën e dytë) rreth 50% në fazën e dytë nuk ka matje të saktë dhe regjistron me pak energjinë e shpenzuar. Kontrollimi i Grupit matës bëhet me instrument "ZERA" si dhe ka evidentuar se duhet të bëhet ndërrimi i transformatorëve rrymor. Provë: Raporti mbi kontrollimin-pranimin e Grupit matës nr. 0209153 datë 09.10.2020

Me datë 11.10.2020 punëtorët e autorizuar të KEDS-it për inspektimin e pikave matëse kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit ku kanë evidentuar shpenzimet e regjistruara në njehsorin elektrik nr. 97830357 me gjendje të njehsorit elektrik aktiv TL=1567,146 kWh dhe TU=388,397 kWh dhe gjendja e njehsorit reaktiv TL=947,514 kVAr dhe TU=279,642 kVAr. Ekipi i KEDS-it ka evidentuar në procesverbal se: bëhet largimi i blloqve të Grupit matës për shkak të



kontrollës dhe ndërrimit të transformatorëve rrymore. Transformatorët rrymor të demontuar 75/5 janë kontrolluar me instrument (CT-analizator) dhe një TMR i fazës së dytë me Nr.2210/15 nuk ka matje të saktë dhe janë në Distrikt Prishtinë, të korrigohet nga AMR. TMR e vendosura janë 3x30/5 (konstantja e faturimit të kalojë në CCP në $C_a=2100$, $C_r=2100$ dhe $C_m=2100$, Ekipi i KEDS-it po ashtu ka evidentuar se një kopje i lihet konsumatorit pasi që refuzon të nënshkruaj. **Provë:** Raporti mbi kontrollimin-pranimin e grupit matës nr. 0209154 datë 11.10.2020

Departamenti i faturimit në KESCO me datë 30.10.2020 e ka ngarkuar konsumatorin me korrigjim plotësues nr. 53063DPZ-9024082 në vlerë financiare 30,839.26€ duke bërë korrigjimin plotësues për periudhën 10/2019 deri në periudhën 11.10.2020 për shkak të mos regjistrimit të saktë të shpenzimeve.

Provë: Korrigjimi nr. 53063DPZ-9024082 datë 30.10.2020

Me datë 13.11.2020 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KESCO duke kundërshtuar korrigjim plotësues nr. 53063DPZ-9024082 datë 30.10.2020.

Provë: Ankesa e konsumatorit në KESCO datë 13.11.2020

Me datë 08.12.2020 Departamenti për Konsumator në KESCO i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar ankesën e tij në arsyetimin se sipas procesverbalit nr. 0209154 i datës 11.10.2020 mbi kontrollimin e pikës matëse përfshirë të gjitha elementet si dhe TMRR ku njeri TMRR ka qenë i djegur në brendësi të tij dhe sipas testimeve me CT analizatorë herësi i tij ka qenë për $\frac{1}{2}$ e reales (apo me gabim të 50% të reales) e njëjta konstatohet edhe me leximet e AMR ku merret rezultati se gabimi ka qenë që nga data 14.08.2019 deri me datë 11.10.2020 ndërsa kalkulimi bëhet vetëm për një vit nga data 11.10.2019 dhe atë muaj për muaj sipas faktorit korrektues. Kalkulimi është kryer sipas faktorit korrektues korresponduar me vlerën e testimit dhe pjesëmarrjen e rrymave fazore dhe raportit të vlerave mesatare të tyre IL1, IL2, IL3 ky faktorë merr vlerën $K=1.19974$ në rastet e rrymave simetrike kalkulimi i këtij faktori do kishte formën: $PS=3 \cdot U \cdot I \cdot \cos \phi$, ndërsa ajo e matur dhe $P_m=5/2 \cdot U \cdot I \cdot \cos \phi$, përkatësisht $K=1.2$.

Provë: Përgjigja e KESCO-s e datës 08.12.2020

Me datë 06.12.2020 konsumatori ka parashtruar ankesë në DMK të ZRRE-së duke kundërshtuar përgjigjen e lëshuar nga KESCO si dhe ka kërkuar të shqyrtohen korrigjimet plotësuese nr. 53063DPZ-9024082 datë 30.10.2020.

Provë: Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së datë 06.12.2020

Bordi i ZRRE-së duke analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e konsumatorit dhe KEDS/KESCO, ka vërejtur se:

Me datë 09.10.2020 punëtorët e autorizuar të KEDS-it për inspektimin e pikave matëse kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit ku kanë evidentuar shpenzimet e regjistruara në njehsorin elektrik nr. 97830357 me gjendje të njehsorit elektrik aktiv $TL=1565$ kWh dhe $TU=388$ kWh dhe gjendja e njehsorit reaktiv $TL=946$ kVar dhe $TU=279$ kVar. Ekipi i KEDS-it ka evidentuar në procesverbal se: Gjatë kontrollimit të Grupit matës është vërejtur se një transformatorë Rrymor (në fazën e dytë) rreth 50% në fazën e dytë nuk ka matje të saktë dhe regjistron me pak energjinë e shpenzuar. Kontrollimi i Grupit matës bëhet me instrument "ZERA" si dhe ka evidentuar se duhet të bëhet ndërrimi i transformatorëve rrymor. Bordi i ZRRE ka analizuar procesverbalin e kontrollimit të grupit matës dhe konstaton se ekipi i matjeve të KEDS-it ka



evidentuar se herësi i transformit të TMRR është 75/5 po ashtu që $L1=58V$, $L2=58V$ dhe $L3=58V$ si dhe për rrymat $I1=0.74A$, $I2=0.35A$ dhe $I3=0.75$ ku vërtetohet se në fazën e dytë $I2$ ka vlerë të përgjysmuar.

Me datë 11.10.2020 punëtorët e autorizuar të KEDS-it për inspektimin e pikave matëse kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit ku kanë evidentuar shpenzimet e regjistruara në njëhisorin elektrik nr. 97830357 me gjendje të njëhisorit elektrik aktiv $TL=1567,146$ kWh dhe $TU=388,397$ kWh dhe gjendja e njëhisorit reaktiv $TL=947,514$ kVAr dhe $TU=279,642$ kVAr. Ekipi i KEDS-it ka evidentuar në procesverbal se: behet largimi i bllobove të Grupit matës për shkak të kontrollës dhe ndërrimit të transformatorëve rrymor. Transformatorët rrymor të demontuar 75/5 janë kontrolluar me instrument (CT-analizator) dhe një TMR i fazës së dytë me Nr.2210/15 nuk ka matje të saktë dhe janë në Distrikt Prishtinë, të korrigjohet nga AMR. TMR e vendosura janë 3x30/5 (konstantja e faturimit të kalojë në CCP) në $Ca=2100$, $Cr=2100$ dhe $Cm=2100$, Ekipi i KEDS-it po ashtu ka evidentuar se një kopje i lihet konsumatorit pasi që refuzon të nënshkruaj. Bazuar në analizën e procesverbalit vërtetohet se herësi i TMRR ka ndryshuar nga 75/5 në 30/5 por që nuk janë dhënë arsyet e ndërrimit të herësit të transformimit nga ata fillestar 75/5 kurse pas rregullimeve dhe matjeve kemi: $L1=57V$, $L2=57V$ dhe $L3=57V$ si dhe për rrymat $I1=0.69A$, $I2=0.72A$ dhe $I3=0.74$ ku vërtetohet se në të gjitha fazat rrymat kanë vlera të njëjta.

Departamenti i faturimit në KESCO me datë 30.10.2020 e ka ngarkuar konsumatorin me korrigjim plotësues nr. 53063DPZ-9024082 në vlerë financiare **30,839.26€** duke bërë korrigjimin plotësues për periudhën 10/2019 deri në periudhën 11.10.2020 për shkak të mos regjistrimit të saktë të shpenzimeve. Me datë 06.12.2020 konsumatori ka parashtruar ankesë në DMK të ZRRE-së duke kundërshtuar përgjigjen e lëshuar nga KESCO si dhe ka kërkuar të shqyrtohen korrigjimet plotësuese nr. 53063DPZ-9024082 datë 30.10.2020. Me datë 08.12.2020 Departamenti për Konsumator në KESCO i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar ankesën e tij në arsyetimin se sipas procesverbalit nr. 0209154 i datës 11.10.2020 mbi kontrollimin e pikës matëse përfshirë të gjitha elementet si dhe TMRR ku njeri TMRR ka qenë i djegur në brendësi të tij dhe sipas testimeve me CT analizatorë herësi i tij ka qenë për $\frac{1}{2}$ e reales (apo me gabim të 50% të reales) e njëjta konstatohet edhe me leximet e AMR ku merret rezultati se gabimi ka qenë që nga data 14.08.2019 deri me datë 11.10.2020 ndërsa kalkulimi behet vetëm për një vit nga data 11.10.2019 dhe atë muaj për muaj sipas faktorit korrektues. Kalkulimi është kryer sipas faktorit korrektues korresponduar me vlerën e testimit dhe pjesëmarrjen e rrymave fazore dhe raportit të vlerave mesatare të tyre $IL1$, $IL2$, $IL3$ ky faktorë merr vlerën $K=1.19974$ në rastet e rrymave simetrike kalkulimi i këtij faktori do kishte formën: $PS=3*U*I*cos\phi$, ndërsa ajo e matur dhe $Pm=5/2 U*I*cos\phi$, përkatësisht $K=1.2$.

Bordi i ZRRE ka analizuar rrjedhën e energjisë elektrike të konsumatorit dhe konstaton se konsumatori në periudha të ndryshme ka ndryshim në shpenzim të energjisë elektrike. Me qëllim të krahasimit të shpenzimeve të konsumatorit është bërë krahasimi i shpenzimeve për periudha të njëjta kohore me dy njëhisorët elektrik, njëhisorin kontestues nr. 97830357 si dhe me njëhisorin e ri nr. 55665166 dhe konstatohet se ka ndryshim në shpenzime. Bazuar në rrjedhën e energjisë elektrike me njëhisorin e vjetër nr.97830357 shpenzimi mesatar mujor është: periudha 10/2017 deri në periudhën 09/2018 është **181,956 kWh/muaj**, periudha 10/2018 deri në periudhën 09/2019 është **217,696 kWh/muaj** dhe periudhën kontestuese 10/2019 deri në periudhën



09/2020 është 177,459 kWh/muaj kurse me njehsorin e ri elektrik nr. 55665166: periudha 12/2020 deri ne periudhën 09/2021 është 222,789 kWh/muaj dhe periudhën 10/2021 deri ne periudhën 09/2022 është 228,050 kWh/muaj.

Bordi i ZRRE duke pasur parasysh përgjegjësit e KEDS-it ne leximin dhe inspektimin, testimin e GM ka kërkuar nga KEDS qe te ofrohen raportet e kontrollimit te GM per periudhën 2018 , 2019, 2020 dhe 2021. Sipas procesverbaleve te dorëzuar vërtetohet se kontrollimi i GM nr. 97830357 ne vitin 2018 është bere ë periudhën 06/2018 kurse per vitin 2019 me datë 24.12.2019 e qe i bie pas periudhës 18 mujore. Bordi i ZRRE ka analizuar raportin mbi kontrollimin – pranimin e grupit matës nr. 0009720 datë 24.12.2019 dhe konstaton se edhe ne këtë procesverbal pas matjeve te bëra është identifikuar se rrymat ne tri fazat nuk kanë vlerë të ngjashme përkatësisht qe rryma ne fazën e dyte ka vlerë me te ulet/përgjysmuar ku $I_1=0.60A$, $I_2=0.28A$ dhe $I_3=0.62A$ por qe nga ekipi i KEDS nuk është marr apo edhe udhëzuar per masat te cilat duhet te merren me qellim te rregullimit te GM përveç se kanë evidentuar se per kontrollimin e TMRR dhe TMT dhe lidhjet e GM duhet te ndalet tensioni 35 kV i konsumatorit.

Bazuar në kodin e matjes përkatësisht nenin 3.9.4 dhe 3.9.5 (Testimi i sistemeve matëse dhe njehsorëve duhet të bëhet në mënyrë periodike) si dhe nenin 4.3.2 përcaktohen qartë detyrimet e OSSH-së lidhur me inspektimin dhe testimin e njehsorëve brenda periudhave te caktuara kohore si dhe përgjegjësinë mbi operimin dhe mirëmbajtjen e njehsorëve elektrik. Ne nenin 3.9.4 thuhet se: Njehsorët gjysmë indirekt multifunksional të cilët kyçen përmes TMRR duhet që së paku 1 (një) herë në vit ose kur të merret ankesa, cilado kohë që është më e shkurtër te testohen”, kurse në nenin 3.9.5 thuhet se:” Testimi i përbashkët në prezencë të përfaqësuesit të konsumatorit kurdo që është e mundur posaçërisht TMRR, TMT, Njehsorët e kërkesës maksimale (të ashtuquajturit GM multifunksional) duhet të bëhet në bazë vjetore, ose në çdo gjashtë muaj varësisht nga rasti që paraqitet, e që ne rastin e konsumatorit *Perparim Hoxha ("Progres" SH.P.K)* asnjeri rast nuk është respektuar kurse në nenin 4.3.2 thuhet se:” Operimi dhe mirëmbajtja e Sistemit të njehsorit përfshinë instalimin e bërë në bazë të standardeve të kërkuara, mirëmbajtjen e rregullt, kontrollimin e TMRR, TMT, dhe njehsorëve tjerë, instalimin e përçuesve, terminallet, shtrirjen e mirëfilltë të kabllëve, mbrojtjen, pastrimin dhe gjendjen e lidhjeve të kutive të njehsorëve, gjendjen e plombave, leximin ditor të rregullt të njehsorëve si dhe nxjerrjen e të dhënave nga pajisja për lexim, nga Qendra Grumbulluese e të Dhënave si dhe kushtimit të vëmendjes për ndonjë prishje eventuale të sistemit të njehsorëve matës. Bazuar ne dokumentacionin e ofruar nga KEDS konstatohet se nenet 3.9.4 dhe 3.9.5 janë respektuar pjesërisht nga KEDS per periudhën 06/2018 deri ne periudhën 10/2020 pasi që nuk është ofruar asnjë dokument me te cilët vërtetohet shqyrtimi i plote periodik I grup matësit te konsumatorit kurse neni 4.3.2 vërteton përgjegjësin e OSSH-së per grup matësin nr. 97830357.

ZRRE ka shqyrtuar korrigjimin e bërë nga Departamenti i faturimit në KESCO nr. 53063DPZ-9024082 datë 30.10.2020 per faturat e periudhës 10/2019 deri ne periudhën 09/2020 e i cili është bërë duke u thirrur ne nenin 4.11.1 te Kodit të Matjes së OSSH-së dhe konstaton se KESCO ka vepruar konform këtij neni pasi që neni 4.11.1 përcakton rastet kur njehsori elektrik është teknikisht jo ne rregull ku edhe thuhet se: “Pas testimit të pajisjeve matëse dhe pasi që vërtetohet kufiri i pasaktësisë përpilohet raporti për gjendjen dhe vlerat e testuara të njehsorit. Pavarësisht a është gabimi në plus ose minus dhe tejkalon vlerën 3 herë e klasës së saktësisë (p.sh. për njehsorët e drejtpërdrejtë klasa e saktësisë është 2.0 , kufiri i lejuar do të ishte 6.0%) atëherë bëhet ri-llogaritja e energjisë dhe përmirësimi i faturimit për 12 (dymbëdhjetë) muajt e fundit përkatësisht 6 muajt e fundit për konsumatorët shtëpiak. Kur vendoset njehsori kontrollues dhe kur vërtetohet se dallimi në lexim është 1.5 herë më i lartë, atëherë veprohet siç u tha më lart. Sipas korrigjimit



te bërë vërtetohet se konsumatori është ngarkuar me korrigjim plotësues per 425,347.22 kWh, 1,398.77 kW si dhe 114,747.28 kVARh, mirëpo Bordi i ZRRE bazuar ne te gjitha analizat konstaton se periudha e korrigjimit te faturave duhet te merret nga 01/2020 deri ne periudhën 09/2020 duke marre per baze se shqyrtimi i fundit i njehsorit nr. 97830357 nga ekipet e autorizuar të KEDS është bere me datë 24.12.2019.

Bordi i ZRRE duke pasur parasysh te gjitha faktet e përmendura me lartë, Raportet mbi kontrollimin – pranimin e grupit matës, nr.046768 datë 06/2018, nr. 0009720 datë 24.12.2019, nr. 0209153 datë 09.10.2020, nr. 0209154 datë 11.10.2020, mos respektimin e neneve 3.9.4 dhe 3.9.5 te Kodit te matjes që kanë te bëjnë me inspektimin dhe testimin e pajisjeve matëse multifunksionale (GP) brenda periudhës se caktuar, nenin 4.3.2 të Kodit të matjes me te cilin është e përcaktuar përgjegjësia e mbi operimin dhe mirëmbajtjen e njehsorëve elektrik si dhe korrigjimin nr. 53063DPZ-9024082 datë 30.10.2020, e të tjera shkresa, në mbledhjen e mbajtur me datë 16.11.2022 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.


Bordi i ZRRE-së:


Ymer Pejzullahu, kryesues


Selman Hoti, anëtar


Izet Rushiti, anëtar


Lutfije Dervishi, anëtare


Gani Buçaj, anëtar



Vendimi iu dërgohet:

- Konsumatorit: *Përparim Hoxha ("Progres" SH.P.K)*
- KESCO-së dhe
- Arkivit të ZRRE-së.